

Zgjedhjet lokale 2021 dhe lufta kundër korrupsionit në nivel lokal

Vetëqeverisja lokale është themeli i demokracisë. Komunat, si format më të afërta të qeverisjes me qytetarët, duhet të plotësojnë interesat dhe nevojat e tyre në nivel lokal.

Fushatat zgjedhore janë periudhë kur pretendentët për pushtetin lokal, arsyetojnë angazhimet, vizionin dhe programin për zhvillim për katër vitet e ardhshme. Në kushtet e besimit të lëkundur të qytetarëve në institucionet, periudha parazgjedhore është mundësi për të bindur votuesit se zgjedhjet lokale, megjithatë janë mundësi për përmirësimin e qeverisjes në nivel lokal.

Qytetarët besojnë se korrupsioni është dukshëm i pranishëm në nivelin lokal. Megjithatë, jashtë fushatës zgjedhore, lufta kundër korrupsionit në nivel lokal është prioritet i pjesshëm i autoriteteve vendore. Të paktën në nivel deklarativ, ai angazhim ndryshon gjatë periudhës parazgjedhore kur vërehet fokus i konsiderueshëm në luftën kundër korrupsionit, si në aspektin e shkaqeve ashtu edhe në efektet e tij negative, të cilat janë veçanërisht të dukshme në nivelin lokal.

Por pyetja është se çfarë po bëjnë komunat për të luftuar korrupsionin. Qëllimi është që komunat të japin vendime, si për shembull plane dhe leje, që do të jenë në interesin publik dhe jo në dëm të tyre. Qëllimi është që ata të shpenzojnë paratë e qytetarëve në mënyrën më të mirë të mundshme, duke ofruar shërbime dhe kushte për qytetarët, përmes përdorimit të fondeve me nikoqirllëk.

Realiteti është se një numër i vogël i komunave kanë miratuar dokumente kundër korrupsionit ose kanë zhvilluar mekanizma për parandalimin e korrupsionit. Kjo është në kundërshtim me pritjet e qytetarëve për një luftë të hapur dhe transparente kundër korrupsionit në të gjitha nivelet. Kjo luftë është po aq e rëndësishme për pushtetin lokal. Lufta kundër korrupsionit nga narracioni parazgjedhor duhet të kthehet në hapa konkretë pas zgjedhjeve. Këshilltarët dhe kryetarët e komunave, kanë detyrim, por edhe në mundësi të luftojnë korrupsionin në punën e tyre dhe duhet të imponojnë luftën kundër korrupsionit si një temë qendrore të punës komunale.

Për fillim, komunat duhet të vlerësojnë rreziqet e korrupsionit në punën e tyre, në mënyrë që të zhvillojnë politika kundër korrupsionit. Ky vlerësim është i nevojshëm për të identifikuar dobësitë në funksionimin e komunave dhe hendequn që paraqitet midis praktikës dhe mënyrës së konceptimit të procedurave në letër. Në këtë mënyrë, autoritetet komunale mund të përcaktojnë çfarë duhet të përmirësohet dhe të përcaktojnë se cilat kapaciteti i nevojitet për ta bërë këtë. Mënyra e planifikimit urban, zhvillimi ekonomik, lëshimi i lejeve, punësimi dhe prokurimet publike janë fushat ku këto politika antikorrupsion duhet të detajohen dhe të hapin rrugën për zhvillimin e ardhshëm të bazuar në integritet dhe anti-korrupsion.

Projekti "Biseda anti -korrupsion në Kuvend (Anti-Corruption Talk in Parliament (ACT in Parliament)) përfshin aktivitete kërkimore dhe përfaqësuese me qëllim kryesor, mbështetjen e procesit reformues në Maqedoninë e Veriut, përmes forcimit të rolit mbikëqyrës të Kuvendit në luftën kundër korrupsionit.

Projekti mbështetet nga Fondi Nacional për Demokraci (National Endowment for Democracy - NED) i Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Për përmbajtjen është përgjegjës IDSCS dhe në asnjë mënyrë nuk pasqyron pozicionet e Fondit Nacional për Demokraci (National Endowment for Democracy - NED).

